



**Universiteti Politeknik i Tiranës  
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike  
Departamenti i Elektronikës**

***PLANI MËSIMOR  
I STUDIMEVE UNIVERSITARE***

**DIPLOMË E CIKLIT TË PARË**

**INXHINIERI MEKATRONIKE**

**180 KREDITE**

**TIRANË 2005**

## ANALIZA MATEMATIKE I

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	I	3	3	-	6

Bashkësia e numrave reale. Funksioni i nje variabli, menytrat e dhenies. Funksionet elementare. Limiti e vazhdueshmeria. Limiti i vargut. Limiti i funksionit. Madhesite p. m. v. e p. m. m. Vazhdueshmeria e funksionit, pikat e keputjes. Vetit te funksioneve te vazhdueshem ne segmente. Derivati dhe diferenciali. Perkufizimi i derivatit, kuptimi gjeometrik e mekanik. Rregullat e derivimit. Diferenciali, kuptimi gjeometrik. Derivatet dhe diferencialet e rendeve te larta. Teoremat Ferma, Role, Langranzh, Koshi. Rregullat e Lopitalit. Formula e Tailorit. Studimi i funksionit. Monotonia dhe esktrimet. Lugetia, pikat e infleksionit. Asimptotat. Integrali i pacaktuar, metodat e integrimit. Integrimi i funksioneve racionale. Integrimi i funksioneve irracionale e trigonometrike. Integrali i caktuar, kuptimi gjeometrik. Formula e Njuton Leibnicit. Metoda llogaritje te integralit te caktuar. Integralet me kufij te pafundem. Integrimi i funksioneve te pakufizuara. Zbatime te integralit te caktuar. Llogaritja e syprinave, gjatesise se harkut, volumeve. Zbatime mekanike. Serite numerike, kriteret e konvergjences. Serite funksionale. Serite polinomiale, intervali i konvergjences. Zberthimi ne serine e Tailorit.

### LITERATURA:

“Analiza matematike I, II” Jorgo Malita, Akli Fundo  
 “Ushtrime te analizes matematike”(Per Fakultetet Inxhinierike), Viktor Kabili, etj.  
 “Analiza matematike I” Luigj Gjoka  
 “Problema dhe ushtrime te Analizes matematike”(Perkthim, Dispensa I, II) A. Bardulla, V. Kedhi

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

## FIZIKA I

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	I	2	1.5	1.5	5

Hyrje. Element te metrologjise: koncepti i madhesise fizike. Kinematika e pikes materiale. Sistemet e referimit. Levizja e njetrajtshme, levizja njetrajtshisht e ndryshuar Kinematika e trupit te ngurte. Dinamika e pikes materiale. Ligjet e dinamikës (ligjet e Njutonit Sistemet inercial dhe jo inercial. Forcat e inercise, raste te ndryshme. Impulsi Energjia kinetike. Puna. Forca konservative dhe jo konservative. Potenciali, energjia potenciale. Ligji i ruajtjes se energjise mekanike. Kurbat e energjise potenciale dhe kufite e levizjes se trupave. Elemente te teorise speciale te relativitetit. Transformimet

e Lorencit. Dinamika relativiste. Levizja lekundese. Lekundjet qe shuhen. Lekundjet e detyruara. Valet. Ekuacioni i vales se rrafshte. Mekanika e sistemit te pikave materiale, forca te brendeshe dhe forca te jashtme. Ligji i terheqjes se gjithesishme. Fusha gravitacionale. Dinamika e trupit te ngurte. Puna dhe energjia kinetike ne levizjen rrotulluese. Ngarkesat elektrike. Ligji i Kulonit. Fusha elektrostатike. Puna e forcave te fushes elektrostатike. Potenciali. Siperfaqet ekuipotenciale.

#### LITERATURA:

“Fizika i “, F. Sinoimeri, Z. Mulaj, B. Duka. SHBLU, Tirane, 1999  
“Corso di Fisica”, Paul A. Tipler Volume 1, Terza edizione, 1985  
“Physic”, Part 1 and 2 combined, David Hallyday, Robert Resnick, New York, 1978  
Grupe autoresh: “Ushtrime te Fizikes se pergjithshme. Per fakultetet e inxhinierise”, Tirane, 1982.

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

### **ALGJEBER DHE GJEOMETRI**

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	I	3	3	-	6

Numerat komplekse. Polinomet-Vektoret ordiner: shuma, prodhimi skalar, prodhimi vektorial. Hapsira vektoriale, hapsira  $R^n$  e  $C^n$ . Nenhapsirat Varesia lineare, Baza dhe dimensionet. Matricat. Veprimet. Rangu. Metoda e reduktimit. Determinantet. Matrica e anasjellt. Sistemet lineare: metoda e reduktimit. Teorema e Rouche capelli. Aplikime lineare. Berthama, imagjinare. Matrica shoqeruese. Autovlera dhe auto vektoret. Diagonalizimi i matricave. Gjeometria analitike e planit dhe e hapesires. Drejteza dhe planet. Sfera dhe rrethi. Format kuadratike kanonike. Cilindri dhe koni. Format kuadratike: matrica shoqeruese dhe format kanonike. Diagonalizimi i matrices simetrike. Klasifikimi i koneve ne plan.

#### LITERATURA:

1. “Algjebra dhe Gjeometria per inxhinierine”(ripunim i plotesuar me ushtrime), Tirane, 2002

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

## KIMI

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	I	2	2	-	4

Struktura e lendes dhe klasifikimi i elementeve: Atomi i hidrogjenit dhe i sistemeve hidrogjenoid. Numrat kuantik dhe orbitale atomike dhe molekulare. Konfigurimi elektronik i elementeve. Lidhja kimike jonike, kovalente, dative, metalore, lidhjet ndermolekulare. Elektonegativiteti dhe polarizimi i nje lidhje. Struktura dhe cilesit te kristaleve te solide, qeliza elementare, difraksioni i rrezeve-X. Solucione solide intersticiais dhe zevendesuese. Periodiciteti ne cilesit kimike dhe fizike te elementeve. Sistemet e kthyeshem dhe ne ekuilibër. Ligjet e veprimit te mases. Ekuilibrat kimike homogjene dhe heterogjene. Principi i Le Chatelier-Brown. Sistemet me shume faza dhe diagramat e gjendjeve. Gjendja e lenget dhe solucionet e lengshme. Cilesi lidhese te solucioneve ujore. Shperbashkimi (disociazioni) elektolitik. Percjellshmeria e solucioneve elektolitike. Produkti jonik i ujit. Percaktimi i pH dhe pOH. Hidroliza. Elektokimia. Elektoliza dhe ligjet e Faraday. Qelizat elektrokimike dhe pilat e tensionit. Potencialet normale te oksidoreduktimit. Forca elektromotorike e nje pile. Elementet e korozionit dhe degradimi i materialeve. Elementet e kimis organike. Hidrokarburet e ngopur, te pangopur dhe aromatike. Grupet kryesore funksionale te kimise organike. Reaksionet e polimerizimit per mbledhjen dhe kondesimin. Cilesit kimike dhe fizike te materialeve polimerike.

### LITERATURA:

“Kimi e pergjithshme, I, II” 1988

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

## GJUHA E HUAJ I

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	I	-	2	3	5

Tematika e ndryshme dhe e larmishme e pasur dhe në funksion të nivelit përkatës. Gramatika dhe format gramatikore. Komunikimi dhe llojet e tij. Leximi dhe shkrimi. Format gramatikore në përdorim. Shprehjet frazeologjike, idiomatike dhe foljet frazale. Pjesët e ligjëratës dhe përdorimet. Teksti, përdorimet kontekstuale dhe terminologjike.

### LITERATURA:

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

## ANALIZA MATEMATIKE II

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	II	3	3	-	6

Seria Furie e funksionit me periode  $2\pi$ . Funksione me periode çfaredo  $T > 0$ . Trajta eksponenciale e series Furie . Ekuacione diferenciale. Ekuacione te rendit te pare me variabla te ndashme, homogjene e lineare. Ekuacione me diferencial te plote. Ekuacione te rendit te dyte. Ekuacione lineare me koeficiente konstante. Sisteme te ekuacioneve lineare me koeficiente konstante. Nje rishikim i numrave komplekse. Funksioni i variablilit kompleks, limiti e vazhdueshmeria. Derivati, kushtet e Koshi-Rimanit. Disa funksione komplekse elementare. Funksione harmonike. Integrimi i funksioneve komplekse, teorema e Koshiut. Transformimi i Laplasit. Kuptimi i origjinalit dhe shembellimit. Vetit te transformimit te Laplasit. Teorema e konvolucionit. Zgjidhja e ekuacioneve diferenciale. Funksioni i Dirakut. Transformimi Furie. Teorema themelore. Trajta te transformimit Furie ne raste te vecanta. Vetit te transformimit Furie. Teoremata e konvolucionit. Shembuj te rendesishem transformimesh Furie.

### LITERATURA:

Jorgo Malita, Akli Fundo “Analiza matematike II”  
 Jorgo Malita “Elemente te teorise se funksioneve te ndryshores komplekse”  
 Viktor Kabili, etj “Ushtrime te Analizes Matematike”  
 Luigj Gjoka “Analiza Matematike”  
 A. Bardulla, V. Kedhi “Ushtime dhe problema te Analizes Matematike” (Perkthim. Dispensa II, III)

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

## FIZIKA II

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	II	2	1.5	1.5	5

Percjellesat ne fushen elektrike. Kapaciteti. Dipoli ne fushen elektrike homogjene dhe heterogjene. Vektori i polarizimit. Fusha elektrike ne dielektrik. Kuptimi i vektorit E dhe D. Vijat e fushes ne kufirin ndares te dy dielektrikeve. Rryma elektrike. Intensiteti dhe densiteti i rrymes. Burimet e rrymes. F. e. m. e nje burimi. Ligji i Ohmit per nje pjese jo homogjene te qarkut Fusha magnetike. Induksioni i saj. Fusha e nje percjellesi me rryme. Veprimi i fushes magnetike mbi percjellesin me rryme. Konturi i mbyllur me rryme ne fushen magnetike homogjene. Veprimi i fushes magnetike mbi ngarkesen qe leviz. Teorema e cirkulacionit te fushes magnetike. Induksioni elektromagnetik. Fusha magnetike ne lende. Intensiteti i fushes. Teoria molekulare e

magnetizmit. Lekundjet elektromagnetike ne konturin L C dhe R L C. Lindja efushes elektrike nga fusha magnetike e ndryshueshme dhe anasjelltas. Fusha elektromagnetike. Perhapja e fushes. Vala elektromagnetike. Drita si vale elektromagnetike. Ligjet e thyerjes dhe pasqyrimin te drites. Natyra kuantike e drites. Rrezatimi termik. Modeli kuantik i atomit te hidrogjenit.

Elemente te fizikes se trupit te ngurte. Zonat energjitike.

#### LITERATURA:

“Fizika i “, F. Sinoimeri, Z. Mulaj, B. Duka. SHBLU, Tirane, 1999.

“Corso di Fisica”, Paul A. Tipler Volume 1, Terza edicione, 1985.

“Physic”, Part 1 and 2 combined, David Hallyday, Robert Resnick, New York, 1978.

Grupe autoresh: “Ushtrime te Fizikes se pergjithshme. Per fakultetet e inxhinierise”, Tirane, 1982.

E. Hysenbegasi, etj” Permbledhje punesh laboratorit ne fizike. Per fakultetet e inxhinierise dhe degen e kimise”, Tirane, 1982.

“Permbledhje punesh laboratorit ne fizike. Per fakultetet e inxhinierise dhe degen e kimise”(shtojce). Katedra e fizikes, Tirane, 1982.

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

### **ELEKTROTEKNIKA I**

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	II	3	1	1	5

Qarqet me parametra të përqendruar dhe ligjet e Kirkofit. Elementet e qarqeve . Analiza e qarqeve të thjeshtë rezistiv. Qarqet e rrymës së vazhduar dhe metodat llogaritëse. Elementet dhe qarqet me ndërlihdje induktive. Analiza e proçeseve kalimtare në qarqet elektrike. Grafet e qarkut dhe teorema e Tellegenit. Analiza e qarqeve me metodën e fazoreve. Fuqia dhe energjia në regjimin e qëndrueshëm sinusoidal. Analiza e qarqeve në regjimin e vendosur sinusoidal. Metoda llogaritëse të qarqeve të rrymës sinusoidale. Rezonanca në qarqet elektrike. Sistemet trefazore të ndryshme dhe veçoritë e tyre. Transformatori, qarku i njëvlerëshëm dhe regjimet e punës. Motorat elektrik: të rrymës së vazhduar, asinkron struktura mekanike dhe qarku i njëvlerëshëm.

#### LITERATURA:

Golemi, Bardhyl . Bazat teorike të elektroteknikës. Pjesa i . 1998

Cipo, P, Saqe. L Teoria e qarqeve elektrike Ushtrime Pjesa II, 1992

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

### ANALIZA MATEMATIKE III

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	II	2	1	-	3

Funksionet e disa variablove. Limiti e vazhdueshmeria. Derivatet e pjesshme. Diferenciali i plote. Derivatet dhe diferencialet e rendeve te larta. Ekstremumet e funksionit te dy variablove. Vektor funksioni i argumentit scalar. Limite, vazhdueshmeria, derivati. Plani tangjent i siperfaqjes. Integralet shumefishe. Integrali i dyfishte, kuptimi gjeometrik e fizik. Llogaritja ne koordinata karteziiane. Nderrimi i variablove, kalimi ne koordinata polare. Zbatime te integralit te dyfishte. Integrali i trefishte, llogaritja ne koordinata karteziiane, cilindrike e sferike. Zbatimet fizike Integralet vijeperkuleta te tipit te pare, perkufizimi dhe llogaritja. Integralet vijeperkuleta te tipit te dyte. Formula e Grintit. Pavaresia e integralit nga rruga e integrimit. Integralet siperfaqesore te tipit te pare e te dyte

#### LITERATURA:

Jorgo Malita, Akli Fundo “ Analiza Matematike II”  
 Viktor Kabili , etj. “Ushtrime te Analizes Matematike “(per Fakul. Inxhinerike)  
 Luigj Gjoka “ Analiza Matematike II”  
 A. Bardulla, V. Kredhi “Ushtrime dhe problema te Analizes Matematike” (Perkthim. Despenca II)

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

### PROBABILITETI

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	II	2	1	-	3

Hapesirat e probabilitetit. Variablat e rastit. -Hapesirat te probabiliteteve reale, variablat e rastit diskrete dhe te vazhduar. -Vlera e pritur. Densiteti, pavaresia, vlera e pritur e kushtezuar.

Laborator/ushtime. Ushtrimet do te ndjekin leksionet dhe do te zgjidhen ne tabele nga docenti. Do te jepet informacion per nje software opsional per ndihme.

#### LITERATURA:

Sh. Leka: “Teoria e probabiliteteve dhe Statistika matematike”, Tirane, 1998.  
 Sh. Leka, etj:”Ushtrime te Teorise se probabiliteteve dhe Statistikes matematike”, Tirane , 1986.

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

## KOMUNIKIMI INXHINIERIK

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	II	1	-	1	2

## LITERATURA:

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

## ELEMENTET E INFORMATIKES

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	I	3	1	1	5

### Objektivi:

Në këtë modul jepen koncepte themelorë të informatikës (arkitektura, programet, algoritmet) dhe nocionet bazë të programimit (gjuhët e programimit, teknikat e programimit, tipet kryesorë të të dhënave, strukturat e kontrollit dhe nënprogramet) duke u thelluar në aspektet konceptuale dhe eksperimentale. I jepet një rëndësi e veçantë programimit në kuptimin e metodologjisë për zgjidhjen e problemeve konkrete, duke u nisur nga të kuptuarit, analiza dhe ndryshimi i programeve ekzistues e për të kaluar në mënyrë graduale në kompetenca me shumë “të projektuarit” që çojnë në krijimin e programeve të rinj.

### Programi:

Paraqitja e informacionit numerik dhe jo numerik. Algjebra e Bulit (Boole), funksionet logjike, teoremat e Bulit, nocione elementare të arkitekturës HW/SW (HardWare/SoftWare) në një kompjuter;

Shtrimi i problemit, algoritmet, dekompozimi i problemeve në nën probleme; të dhënat dhe fluksi i veprimeve (operacioneve), variablat, konstantet, shprehjet; diagrama e flukseve (bllok-skema); strategjitë elementare “debug”.

Konstruktet themelorë të programimit duke ju referuar gjuhës C:

Sintaksa dhe ngjashmëria bazë e gjuhës C;

Variablat, tipet dhe dhënia e vlerës;

Konstruktet e kushtëzuar dhe iterative;

Operacionet I/O (Input/Output) elementare (tastiera dhe ekrani);

Funksionet dhe kalimi i parametrave;

Strukturat e të dhënave : tipet primitive (skalarët), vektorët dhe matricat;



Vektorët jo numerikë (String) dhe manipulimi i tyre.

**Laboratore dhe/ose ushtrime:**

Ushtrimet do të ndjekin çështjet e zhvilluara në auditor dhe do të kryhen në laboratorin informatik.

**LITERATURA:**

- A. Gjonaj e te tjere, Programimi dhe gjuha C
- P. Demichelis, E. Piccolo, Introduzione all' Informatica in C
- W. Kernigham, D. M. Ritchie, Programimi ne gjuhen C, Perkthim nga T. Luarasi

**MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES:** Provim me shkrim

**TEKNIKAT DHE GJUHET E PROGRAMIMIT**

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	II	2	1	2	5

**Objektivi:**

Ky modul kompletion hyrjen në informatikë si një element për zgjidhjen e problemeve. Gjatë këtij moduli vendoset theksi në kalimin nga aftësitë analizuese në ato projektuese. Këtu futen konceptet elementare të kompleksitetit të algoritmeve dhe të tipeve të të dhënave abstrakte.

**Programi:**

Skedarët (File) e tipit tekst dhe binar;  
Strukturat e të dhënave : paraqitja e të dhënave në kujtesë; adresuesit (pointers); vendosja e kujtesës statike, në “stack” dhe dinamike; listat e bashkuara, “stack” dhe rradhë;  
administrimi i kujtesës në ekzekutim; strategjitë për zgjedhjen e strukturave të të dhënave;  
Kërkimi i rrugëve të shumëfishta nëpërmjet “stack” dhe rradhës;  
Rekursiviteti: koncepti rekursiv; funksionet matematike rekursive; procedurat e thjeshta rekursive; implementimi i rekursivitetit; strategjia “përçaj dhe sundo”;  
Tipi abstrakt i të dhënave “ADT” (Abstract Data Type): rëndësia e abstragimit; ndërfaqja procedurale e të dhënave; tipi abstrakt i të dhënave; inkapsulimi dhe fshehja e të dhënave; shëmbuj ADT;  
Algoritmet elementare: hyrje në kompleksitetin e algoritmeve dhe matja e efikasitetit (performance); kërkimi sekuencial dhe binar; rregulli kuadratik, linear dhe logaritmik.

Laboratore dhe / ose ushtrime :

Ushtrimet do të ndjekin çështjet e zhvilluara në auditor dhe do të kryhen në laboratorin informatik. Ushtrimet do të kenë si temë zhvillimin e programeve në gjuhën C.

## LITERATURA:

- A. Gjonaj e te tjere, Programimi dhe gjuha C  
P. Demichelis, E. Piccolo, Introduzione all'Informatica in C  
W. Kernigham, D. M. Ritchie, Programimi ne gjuhen C, Perkthim nga T. Luarasi

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim

## **ANALIZE NUMERIKE**

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	I	1.5	1	0.5	3

Gabimet e rumbullakimit. Aritmetika e kompjuterit.

Interpolimi dhe përafrimi polinomial. Polinomi i Lagranzhit. Diferencat e ndara dhe të fundme. Interpolimi i Hermitit. Interpolimi me Spline Kubik. Polinomet ortogonale dhe metoda e katroreve më të vegjël. Përafrimi me funksione racionale. Përafrimi me polinome trigonometrike dhe transformimi i shpejtë Furie ( FFT ).

Diferencimi dhe integrimi numerik. Zgjidhja e ekuacioneve të një variabli . Metoda e bisektimit, e sekantes dhe Njuton - Rafson. Metoda e Mylerit, e Brentit.

Metodat direkte dhe iterative për zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve lineare.

Metoda e Gausit dhe LU faktorizimi. Metoda Cholesky. Sistemet me matrica band.

Metoda e Jakobit. Metoda Gauss - Zejdel. Metodat SOR dhe AOR.

Zgjidhja numerike e sistemeve të ekuacioneve jolineare me metodën e Njutonit, Kausi – Njutoniane dhe të zbritjes më të shpejtë. Metoda numerike(e Eilerit, trapezoidale, Runge – Kutta, e Adams - Bashforth dhe Adams – Moultonit) për zgjidhjen e ekuacioneve dhe të sistemeve të ekuacioneve diferenciale. Metoda e goditjes, e diferencave të fundme, Ralley-Ritz për problemet kufitare lineare dhe jolineare për ekuacionet diferenciale të zakonshme.

## LITERATURA:

1. V. ZENJO, F. HOXHA Analiza Numerike. Tiranë, 1995.
2. R. L. BWRDEN, J. D. FAIYES Numerical analisis. Boston, 1993.

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

## **GJUHA E HUAJ II**

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	I	-	1	1	2

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

## ELEKTROTEKNIKE II

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime, Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	I	3	1	1	5

Qarqet trifazore. Analiza e qarqeve me anë të vendeve gjeometrike. Qarqet me burime periodike josinusoidale. Elementet jolineare të rrymës së vazhduar dhe të ndryshueshme. Analiza e qarqeve jolineare. Metodmat matricore të analizës nyjore dhe kontureve elementare. Metodmat matricore mbi bazën e kontureve fundamentale dhe prerjeve fundamentale. Ekuacionet e gjendjes. Analiza e qarqeve me anën e transformimit të Laplasit. Transformimi Furie. Metoda spektrore në analizën e proçeseve kalimtare. Frekuencat natyrale. Funkcionet e qarqeve. Qarqet me dy porta dhe shumëpolarët. Qarqet rezistive. Energjia dhe pasiviteti. Qarqet me parametra të shpërndarë në rregjimin e qëndrueshëm dhe kalimtar.

### LITERATURA:

1. Desoer. Ch, Kuh. E: Basic Circuit Theory (përkthim). 1995
2. Golemi, Bardhyl . Bazat teorike të elektroteknikës. Pjesa II, III. 1998
3. Cipo, P, Saqe. L Teoria e qarqeve elektrike Ushtrime Pjesa II, 1992

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

## TEORIA E SINJALEVE

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime, Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	I	3	1	1	5

Transformimi F i sinjaleve deterministe. Thurja dhe konvolucioni i sinjaleve. Sistemet lineare dhe vetitë e tyre. Filtrat si sisteme lineare. Kampionimi dhe kuantizimi i sinjaleve. Modulimi dhe demodulimi i sinjaleve. Sistemet numerike dhe vetitë e tyre. Transformimi në Z. Transformimi Furie diskret. Sinjalet e rastit. Klasifikimi dhe vetitë e tyre. Vlerësimi i sinjaleve të rastit. Kampionimi i sinjaleve të rastit. Vlerësimi i madhësive kryesore të sinjaleve të rastit. Vlerësimet e funksionit të korrelacionit, . densitetit spektral të fuqisë. Filtrimi i sinjaleve të rastit. Zhurmat dhe vlerësimi i tyre.

### LITERATURA:

1. H. MUÇOSTEPA Sinjalet dhe sistemet 2001
2. S. SALIU Përpunimi numerik i sinjaleve 1988

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim

## **AUTOMATIZIM**

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	I	3	1	1	5

Sinjalet, sensorët dhe ekzekutuesit. Vecori të sinjaleve numerike. Probleme të kampionimit të sinjaleve. Rindertimi i sinjaleve të komandës. Automatet e programueshëm. Koncepti i programimit me listë veprimesh. Struktura e diagramës shkallë. Shembuj të niveleve të kompletimit të PLC. Aspekte informatike.

Skema e komandimit. Realizimi i një sistemi komandimi numerik. Drejtimet kryesore të konceptimit informatik. Komunikimi me ekzekutuesit. Programimi. Siguria. Shembuj të aspekteve informatike.

Laboratoret: Vizualizimi i sinjalve. Portat e hyrjes së PLC. Portat e daljes së PLC. Simulimi i një skeme në PLC.

### LITERATURA:

K. Veisllari, Leksione në Automatet e Programueshëm, Tirane 2003

A. J. Crispin, PLC and their engineering applications, McGraw-Hill, 1990

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim

## **MATJET ELEKTRONIKE**

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime, Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	II	3	1	1	5

Oshiloskopi elektronik. Matja e fuqisë dhe e energjisë në qarqet e rrymës së vazhduar dhe alternative. Matja e frekuencës dhe e fazës me teknika analoge dhe numerike. Analiza në frekuencë e sinjaleve. Matja e përgjigjes në frekuencë të një katërpolari. Matje e lëkundjeve të moduluara në amplitudë në frekuencë dhe në fazë. Matja e fuqisë në qarqet elektronike. Voltmetrati elektronik analog dhe numerik Aparatet numerike të matjeve. Sistemet e kompjuterizuar të matjeve.

### LITERATURA:

1. R. ÇANI Matjet elektrike 1986

2. J. AGALLIU Matjet elektronike 2000

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

## ELEMENTET DHE TEKNOLOGJITE ELEKTRONIKE

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime, Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	I	3	1	1	5

Materialet gjysmëpërrjellese. Karakteristikat e diodës me bashkim. Qarqet me diodë. Koncepti i linjës së ngarkesës. Modeli linear i diodës. Qarqet kufizues. Krahasuesat. Porta seleksionuese. Radrizatorët. Qarqet e tjera me valë të plotë. Filtrat kapacitivë. Transistorët me bashkim. Përbërësit e rrymës në transistor. Transistori si amplifikator në frekuencat e ulëta dhe ne frekuencat e larta. Polarizimi i transistorit. Transistorët me efekt fushe. Karakteristikat per EFT. Modeli i FET për sinjal të vogël. MOSFET, karakteristikat. Qarqet shifrore MOS. Polarizimi i FET. Transistori në frekuencat e larta. Modeli Hibrid- $\pi$  i transistorit me emiter të përbashkët. Parametrat Hibrid- $\pi$ . Karakteristika në frekuenca të larta.

### LITERATURA:

1. R. Mitrusi (Miho) Elementet e Elektronikës, 2005
2. J. MILLMAN & C. HALKIAS Elektronika e Integruar 1 (Përkthim)
3. A.S.SEDRA & K.C.SMITH Microelectronics Circuits. 1998

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim

## TEKNOLOGJI MEKANIKE

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime, Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	I	3	1	1	5

### **Objektivi:**

Ky modul trajton proceset teknologjike te perdorura ne industri, strukturen e pergjithshme dhe komponentet e makinave, ne vecanti te makinave qe perdorin kontrollin numerik. Jepen metodat dhe gjuhet e programimit te makinave qe perdorin kontrollin numerik, si dhe parimet baze fizike dhe parametrat e procesit te punes.

### **Programi:**

Makinat e komanduara me kontroll numerik: struktura dhe programimi.  
 Vetite mekanike te materialeve.  
 Proceset e punes per perpunimin e materialeve.  
 Proceset e fabrikimit.  
 Deformimi plastik i materialeve.  
 Proceset e saldimit, etj.

## LITERATURA:

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim

### **SISTEMET ELEKTRONIKE**

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime, Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	II	3	1	1	5

Sistemet e numërimit. Qarqet sekuenciale MSI: regjistrat rëshqitës, gjeneruesit e sekuencave, numëruesit. Struktura dhe sisteza e tyre. Sinteza e sistemeve sekuenciale me qarqe të shkallës së mesme të integritimit.

Aritmetika binare, paraqitja e numrave dhe mbledhja. Realizimi i operacioneve të tjera aritmetike. ALU. Kujtesa me gjysmëpërçues. Kujtesa FIFO dhe LIFO, ROM dhe programimi i tyre. Kujtesat RAM, organizimi adresimi, zgjerimi i kapacitetit, leximi dhe shkrimi në kujtesë i tyre. Gjeneruesi i karaktereve, etj.

Amplifikatorët me shumë stade. Diagrama Bode. Brezi i lejimit i stadeve kaskade. Amplifikatorët me çiftim të kundërt negativ. Karakteristikat e përgjithshme. Analiza e disa skema me çiftim të kundërt negativ. Përgjigja në frekuencë e amplifikatorit me çiftim të kundërt negativ dhe analiza e përgjithshme e tyre. Zbatimet kryesore të AO si bllok ndërtimi analog. Filtrat aktiv të ndryshëm. Amplifikatorët e fuqisë të klasave të ndryshme. Amplifikatorët me brez të ngushtë.

## LITERATURA:

1. J. Agalli Elektronika Lineare 2001
2. Sedra & Smith Microelectronics circuits 1998
3. Vangjel ZAKA Elektronika Numerike. SHBLU. Tiranë, 1996
4. John F. Wakerly Digital Design, Principles and Practices 2001, Prentice Hall

MENYRA E VLERESIMIT TE LENDES: Provim me shkrim dhe me goje

### **ALGORITEM DHE PROGRAMIM I AVANCUAR**

Kodi i lëndës	Semestri	Ndarja e krediteve të lëndës			Kredite
		Leksione	Ushtrime, Seminare	Laboratore, Projekte, Detyra	
	II	2	1	2	5

Krahasimet midis C++ dhe C. Programimi i orientuar nga objekti. Ndërtimi i një programi në C++. Paraproçesorët, komentet, variablat. Funksionet e librarive, file header të ndërtuara nga përdoruesi dhe manipulatore. Kushti *if*, cikli *while* dhe *do while*. Cikli *for*, çelësi *switch*, operatorët logjike, fjalët kyçe *break*, *continue*. Strukturat, tipi i të dhënave

